

Transoilgroup sh. a

**Pasqyrat financiare për vitin e mbyllur
më 31 Dhjetor 2013**

Përmbajtja

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	
BILANCI KONTABËL	1
PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE	2
PAQYRA E NDRYSHIMIT NË KAPITAL	3
PASQYRA E FLUKSESE MONETARE	4
1. INFORMACIONI I PËRGJITHSHËM	5
2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE	5
3. POLITIKAT KONTABËL TË RËNDËSISHME	7
4. MJETE MONETARE DHE EKVIVALENTË	11
5. INVENTARI	11
6. LLOGARITË E ARKËTUESHME	11
7. PARAPAGIME DHE SHPENZIME TË SHTYRA	11
8. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE	12
9. DETYRIMET AFATAGJATA	13
10. LLOGARITË E PAGUESHME	13
11. LLOGARI TË PAGUESHME TË TJERA	14
12. KAPITALI AKSIONER	14
13. HUAMARRJET	14
14. TË ARDHURAT	15
15. SHPENZIMET PËR MATERIALE	15
16. SHPENZIME PERSONELI	15
17. SHPENZIMET E PËRGJITHSHME DHE ADMINISTRATIVE	16
18. TË ARDHURA/SHPENZIME TË TJERA, NETO	16
19. TË ARDHURA FINANCIARE	16
20. SHPENZIMET FINANCIARE	17
21. TATIM FITIMI	17
22. PALËT E LIDHURA	18
23. ANGAZHIMET DHE PASIGURITË	19
24. NGJARJET PAS DATËS SË BILANCIT	20

OPINIONI I AUDITUESVE TË PAVARUR DREJTUAR AKSIONERËVE TË TRANSOILGROUP SH.A

Raporti mbi pasqyrat financiare

Ne kemi audituar pasqyrat financiare shoqëruese të "Transoilgroup sh.a" ("Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2013, dhe pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe Pasqyrën e lëvizjes së flukseve monetare për vitin ushtrimor të mbyllur, si dhe një përmbledje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e drejtimit per pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sigurtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) dhe për ato kontrole të brendshme, të cilat drejtimi i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare që janë pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose të gabimeve.

Përgjegjësia e audituesve

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë e të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare janë pa anomali materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për sigurimin e të dhënave të auditimit për shumat dhe deklaratimet në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të këtyre rreziqeve, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e sigurtë të pasqyrave financiare të shoqërisë në mënyrë që të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat financiare, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionit për efektivitetin e kontrollit të brendshëm të shoqërisë. Një auditim gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së parimeve të kontabilitetit të përdorura dhe pranueshmërinë e cmuarjeve kontabile të kryera nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë të auditimit.

Opinionit

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të sigurtë të pozicionit financiar të Shoqërisë më 31 Dhjetor 2013, si dhe të performancës financiare dhe të flukseve monetare të saj për vitin ushtrimor të mbyllur, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.

Theksimi i çështjes

Siç është shpalosur në Shënimin 2.5 të pasqyrave financiare, aftësia e Shoqërisë për të përmbushur angazhimet e saj investuese afat-mesme dhe të gjata afatgjata është e varur në zbatimin e suksesshëm të Marrëveshjes Tunkey Drilling. Opinioni ynë nuk është i modifikuar në këtë drejtim.

Ernst & Young Certified Auditors Sh.p.k

9 Shtator 2013

Ernst & Young Certified Auditors Sh.p.k.
Shkup- Dega Tiranë

Mario Vangjeli
Ekspert Kontabël i Regjistruar

Transoilgroup sh.a

BILANCI KONTABËL

Më 31 Dhjetor 2013

(shumat në mijë Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

	Shënime	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Aktive afatgjata materiale	8	694.833	393.402
<u>Totali i aktiveve afatgjata</u>		694.833	393.402
Inventari	5	240.089	45.438
Llogari të arkëtueshme	6	160.350	172.681
TVSH e arkëtueshme		7.681	5.811
Te arkëtueshme nga pelët e lidhura		375	-
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	7	207.361	2.094
Mjete monetare dhe depozita afatshkurtra	4	103.157	1.175
<u>Totali i aktiveve afatshkurtra</u>		719.013	227.199
TOTALI AKTIVEVE		1.413.846	620.601
Kapitali aksioner	12	10.000	10.000
Fitim/ Humbje e pashpërndarë		(1.607.711)	(759.625)
<u>Totali i kapitalit aksioner</u>		(1.597.711)	(749.625)
<u>Detyrimet afatgjata</u>			
Detyrime afatgjata	9	943.552	42.965
Pjesa afatgjatë e detyrimit të qerasë financiare	13	1.510	3.692
		945.062	46.657
<u>Detyrime afatshkurtra</u>			
Llogari të pagueshme	10	661.486	742.101
Detyrime afatshkurtra të tjera	11	39.997	138.840
Pjesa afatshkurtër e detyrimit të qerasë financiare	13	2.159	2.172
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	22	1.362.853	440.456
		2.066.495	1.323.569
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT AKSIONER		1.413.846	620.601

Bilanci kontabël duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5–20 që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga drejtimi i shoqërisë më 28 Shkurt 2014.

Av. Shefqet Dizdani

Administratori

Din Prengzi

Hartuesi

Transoilgroup sh.a

PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(shumat në mijë Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2013	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2012
Shitjet	14	334.190	514.951
Renta Minerare		(33.419)	(51.495)
Të ardhurat neto		300.771	463.456
Shpenzimet për materiale	15	(959.849)	(764.538)
Ndryshimi i gjendjes se inventarit		156.151	40.072
Shpenzimet e personelit	16	(166.452)	(141.172)
Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative	17	(207.665)	(118.662)
Zhvlerësimi dhe Amortizimi	8	(24.777)	(2.855)
Të ardhura/ Shpenzime të tjera neto	18	27.012	(230.499)
Humbje nga veprimtaria operative		(874.809)	(754.198)
Të ardhura financiare	19	28.567	684
Shpenzime financiare	20	(1.844)	(6.111)
Humbja para tatimit		(848.086)	(759.625)
Tatim fitimi	21	-	-
Humbja neto		(848.086)	(759.625)

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5–20 që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Transoilgroup sh.a

PAQYRA E NDRYSHIMIT NË KAPITAL Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(shumat në mije Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

	Kapitali aksioner	Fitimi/ (Humbje) e pashpërndarë	Totali
Më 1 Janar 2012	-	-	-
Kontributi në kapitalin aksioner	10.000	-	10.000
Humbja neto për vitin	-	(759.625)	(759.625)
Më 31 Dhjetor 2012	10.000	(759.625)	(749.625)
Humbja neto për vitin	-	(848.086)	(848.086)
Më 31 Dhjetor 2013	10.000	(1.607.711)	(1.597.711)

Pasqyrat financiare të ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5–20 që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Transoilgroup sh.a

PASQYRA E FLUKSESE MONETARE

Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(shumat në mijë Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

Shënime	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2013	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2012
Fluksi monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit		
Fitimi (humbja) neto para tatimit	(848.086)	(759.625)
Rregullime për:		
Zhvlerësimet dhe amortizimet		
8	24.777	2.855
Provizione afatshkurtër Albpetrol	20.262	123.139
11		
Provizione për nxjerrje jashtë përdorimit	380	907
9		
Kosto për marrjen në kontroll të zonës naftëmbajtëse Visoka	-	192.657
18		
Fitimi operativ përpara rregullimeve në kapitalin punues	(802.667)	(440.067)
Rënia/ (Rritja) në llogaritë të arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme	(195.181)	(180.586)
6		
(Rritja) në inventar	(194.651)	(45.438)
5		
Rënia/ (Rritja) në llogarite e pagueshme dhe të tjera të pagueshme	698.292	805.724
10,11		
Rritja në llogaritë e pagueshme ndaj palëve të lidhura	922.397	247.799
19,22		
Fluksi monetar i gjeneruar nga veprimtaria e shfrytëzimit	428.190	387.432
Fluksi monetar neto nga veprimtaritë e shfrytëzimit	428.190	387.432
Fluksi monetar nga veprimtaritë e investimit		
Blerje prone, makineri dhe pajisje	(326.208)	(396.257)
8		
Fluksi monetar neto i përdorur në veprimtaritë e investimit	(326.208)	(396.257)
Fluksi monetar nga veprimtaritë e financimit		
Kontributi në kapitalin aksioner		
12	-	10.000
Të ardhurat nga huamarrjet		-
Fluksi monetar neto në veprimtaritë e financimit	-	10.000
Rritja/ (Rënia) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të saj	101.982	1.175
4		
Mjete monetare dhe ekuivalentë të saj më 1 Janar	1.175	-
Efektet e ndryshimit të kurseve të këmbimit	-	-
Mjete monetare dhe të tjera më 31 Dhjetor	103.157	1.175

Pasqyrat e flukseve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5–20 që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Transoilgroup sh.a

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(shumat në mije Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

1. INFORMACIONI I PËRGJITHSHËM

Transoilgroup sh.a ("Shoqëria") është themeluar më 22 Nëntor 2011 sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë me qendër në Tiranë. Shoqëria ka filluar aktivitetin gjatë vitit 2012 dhe nuk ka veprimtari të mëparshme. Që nga Shkurti i 2012 Shoqëria është përfshirë në operacionet e kërkimit, zhvillimit dhe prodhimit të hidrokarbureve në Shqipëri..

Shoqëria operon në Shqipëri në zonën naftëmbajtëse të Visokës sipas Marrëveshjes Hidrokarbureve të shoqërisë mëmë Transoilgroup AG (Zvicër) dhe Albpetrol sh.a (Albpetrol), shoqëri ne pronësi shtetërore nën licencën ekzistuese të Albpetrol me Agjensinë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN). Marrëveshja e Visokës u bë efektive në Dhjetor 2008 dhe ka një kohëzgjatje prej 25 vitesh me mundësinë e zgjatjes së afatit, me kërkesë të shoqërisë dhe aprovimin nga qeveria dhe entet regullatore.

Shoqëria më 31 Dhjetor 2013 kishte të punësuar 145 punonjës (31 Dhjetor 2012: 191 punonjës).

2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE

2.1 Baza e përgatitjes

Paqyrat financiare janë përgatitur sipas Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).

Bazuar në SKK 11 "Tatimi mbi fitimin", paragrafi 4, Shoqëria ka zgjedhur të mos njohë tatimet e shtyra në pasqyrat financiare për periudhën që mbyllet më 31 Dhjetor 2013.

2.2 Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3 Monedha funksionale dhe e prezantimit

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek, por USD është monedha funksionale e Shoqërisë.

Kurset zyrtare të këmbimit të monedhave për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013 dhe 2012 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor, 2013	31 Dhjetor, 2012
USD / LEK	101.86	105.85
EURO / LEK	140.20	139.59

2.4 Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtuesit të ushtrojnë gjykimin, vlerësimin dhe supozimet të cilat ndikojnë në aplikimin e pilitikave kontabël dhe raportimin e shumave të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe supozimet e nënvizuara rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

Në veçanti, informacioni mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve kritike në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efekt të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet shpjeguese përkatëse të këtyre pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë e aktiviteve të realizuara nga Shoqëria.

Transoilgroup sh.a

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(shumat në mijë Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE (VAZHDIM)

2.5 Vijueshmëria

Shoqëria është operatori në emër të prindit të tij, Transoilgroup AG, për Marrëveshja e Përbashkët e Prodhimit të naftës ("MPP") midis Transoilgroup dhe Albpetrol sh.a, shoqëria shtetërore e naftës. Sipas kushteve të MPP, është e nevojshme që Shoqëria dhe prindi, duhet të bejnë shpenzime kapitale në fushën e naftës për USD 6 milionë për vitin 2013 dhe një nivel më i lartë shpenzimesh kapitale është parashikuar përtej vitit 2013 në planin e biznesit të Shoqërisë. Investimi ka për qëllim për të përmirësuar pajisjet dhe infrastrukturën ekzistuese, shpimin e puseve të reja dhe rritjen e prodhimit të naftës së papërpunuar në nivele të qëndrueshme tregtare.

Shoqëria ka pasur një humbje neto prej Lek 848.086 mijë gjatë vitit që përfundon më 31 Dhjetor 2013, dhe që nga ajo ditë detyrimet afatshkurtra të shoqërisë tejkalojnë aktivet afatshkurtra me Lek 2.247.689 mijë (2012: Lek 1.096.370 mijë). Megjithatë këto humbje, janë parashikuar në planin e biznesit të Shoqërisë në vitet e para të aktivitetit të Shoqërisë, sepse si pasojë e natyrës së industrisë, niveli i prodhimit nuk do të jetë i tregtueshëm derisa të arrihet niveli i planifikuar i investimeve kapitale. Duke filluar nga data e këtyre pasqyrave financiare, Shoqëria është në rrugën e duhur për të përmbushur objektivin e kërkuar nga "MPP" të investimeve kapitale në shumë 6 milion USD, deri në fund të vitit 2014.

Shoqëria ka nënshkruar një marrëveshje me Gaffney Cline & Associates, një kompani ndërkombëtare këshillimi mbi naftën, e cila ka kryer një vlerësim të rezervës së rikuperueshme në zonën naftëmbajtëse nëpërmjet metodave konvencionale. Raporti i Gaffney Cline & Associates paraqet se më 30 Shtator 2013, Rezervat e Naftës Bruto në zonën e Visokës depozituar në milionë fuci janë si më poshtë:

Të vërtetuara 1P - 37.51 milionë fuci

Të vërtetuara + Të mundshme 2P - 65.32 milionë fuci

Të vërtetuara + Të mundshme +Të mundura 3P - 119.90 milionë fuci

Si rezultat i këtij raporti, Manaxhimi është i bindur për qëndrueshmërinë afatgjatë të fushës së naftës në bazë të raportit të rezervës nga Gaffney, Cline & Associates dhe vlerësimeve shumë mira sipas Brent Price dhe kostove të parashikuara nga Transoilgroup sh.a. mund të thuhet se niveli i mjaftueshëm i investimeve kapitale është arritur.

Për këtë qëllim, kompania ka hyrë në një Marrëveshje shpuese Turnkey Drilling me Porto Romano sh.a siç shpjegohet më poshtë, e cila do të mbështesë kërkesat e investimeve të kompanisë. Sipas Marrëveshjes shpuese Turnkey Drilling, çdo muaj Porto Romano do të paguajë për të Transoilgroup sh.a shumën e barabartë me totalin e Capex-eve, OPEX-eve dhe shpenzimeve administrative që Transoilgroup Sh.a planifikon të shpenzojë në atë muaj të veçantë. Deri në fund të vitit 2014 Porto Romano pritet të mbështesë shpimin e 4 puseve të reja dhe deri në fund të 2015 shpimin e 28 puseve. Sipas marrëveshjes, Porto Romano do të kompensohen me naftë bruto, dhe si rezultat i investimeve të reja kapitale bëhen nëpërmjet Marrëveshjes shpuese Turnkey Drilling, ky fakt nuk do të ndikojë negativisht në rrjedhjen e flukseve monetare të kompanisë e as të kërkojë injeksione të reja të konsiderueshme kapitale në kompani.

Për më tepër kapitali i siguruar nëpërmjet Marrëveshjes shpuese Turnkey Drilling, manaxhmenti i Shoqërisë ka ndërmarrë një sërë hapash për të përmirësuar aftësinë e tij për të siguruar vijueshmërinë e biznesit në terma afat të shkurtër dhe aftësinë e saj për të arritur investimet kapitale në terma afatgjatë dhe të bëjë fushën e naftës fitimprurëse si më poshtë:

- Aksionerët ekzistues kanë transferuar një pakicë aksionesh tek z. Behar Cukaj, aksioner edhe i Porto Romanos. Të ardhurat nga transferimi i aksioneve në shumën prej 6 milionë USD është kontribuar si kredi në vartësi të kompanisë.
- Porto Romano nënshkruan gjitha pretendimet e saj aktuale dhe të ardhshme për dërgesa tretësi (Kërkesat Vartëse) kundër Transoilgroup sh.a për të gjitha borxhet e tjera aktuale ose të ardhshme të pasigurta të Transoilgroup sh.a ndaj të gjithë kreditorëve të tjerë.
- Të gjitha detyrimet e kompanisë mëmë drejt Bordit të Drejtorëve dhe Aksionerët kanë qenë gjithashtu në vartësi dhe operacionet me selinë janë riorganizuar në mënyrë për të reduktuar ndjeshëm kostot.
- Z. Cukaj ka konfirmuar me shkrim më 4 shtator 2014, qëllimin i tij dhe se ai ka aftësi financiare për të kryer angazhimet të marra prej tij në Marrëveshjen shpuese Turnkey Drilling

Transoilgroup sh.a

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(shumat në mijë Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE (VAZHDIM)

2.5 Vijueshmëria (vazhdim)

Si rezultat i këtyre veprimeve, manaxhimi beson se nuk ka risqe materiale për Transoilgroup Albania sh.a. për të mos përbushur detyrimet e tij që vijnë rrjedhimisht dhe se supozimi i vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare është i përshtatshëm. Pikëpamja e Menaxhmentit është mbështetur edhe nga Letra e Supportit e z. Behar Cukaj, datë 4 shtator 2014, e cila konfirmon aftësinë e tij për të realizuar marrëveshjen shpimit Turnkey.

Nga ana tjetër, Menaxhimi pranon se sukcesi i Marrëveshjes shpuese Turnkey me Porto Romano është çelësi për të siguruar angazhimet e kompanisë për investime kapitale dhe qëndrueshmërinë afatgjatë të fushës së naftës

3. POLITIKAT KONTABËL TË RËNDËSISHME

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme në periudhat e paraqitura, përveç rasteve ku specifikohet ndryshe.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në atë datë. Fitimi ose humbja nga këmbimi për zërat monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi. Aktivitetet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë këmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.2 Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme, mjete monetare dhe të tjerë ekuivalentë, huamarrje, dhe llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme. Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë, përveç instrumentave jo me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitetet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur Shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjete monetare dhe të tjerë ekuivalentë

Mjete monetare dhe të tjerë ekuivalentë përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së flukseve monetare, mjetet monetare dhe të tjerë ekuivalentë përfshijnë depozita pa afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen

Transoilgroup sh.a

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(shumat në mijë Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

3. POLITIKAT KONTABËL TË RËNDËSISHME (VAZHDIM)

3.2 Instrumentat financiarë (vazhdim)

tregues që llogaritet e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Huamarrje

Huamarrjet njihen fillimisht me kosto dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve.

Të tjerë

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

3.3 Aktivët Afatgjatë Materiale

Vlera e drejtë

Vlera e drejtë e përlogaritur për mjetet monetare dhe të tjerë ekuivalentë, llogari të arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme, llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme, huamarrjeve, duke zbritur çdo rënie në vlerë, përafron me vlerat e tyre kontabël.

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapital.

(i) Njohja dhe matja

Te gjitha aktivët afatgjatë materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejtë me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejtë me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes si në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga ku aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktiviteti afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjatë materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen për vlerën neto në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

(ii) Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjatë materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që Shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjatë materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi i aktiveve fikse në aktivitetet e prodhimit të hidrokarbureve llogaritet duke përdorur metodën e njësisë-së-prodhimit duke iu referuar përqindjes së prodhimit në vit e lidhur me rezervat e vërtetuara dhe të mundshme, përveç në rastin e aktiveve, jeta e dobishme e të cilave është më e shkurtër se jetëa e fushës, në të cilin rast metoda lineare është aplikuar.

Transoilgroup sh.a

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(shumat në mijë Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

3. POLITIKAT KONTABËL TË RËNDËSISHME (VAZHDIM)

3.3 Aktivet Afatgjata Materiale (vazhdim)

Për aktivet të tjera, amortizimi është njohur në pasqyrën e të ardhurave duke përdorur metodën lineare mbi jetën e dobishme të vlerësuar për cdo pjesë të aktiveve materiale afatgjata. Toka nuk amortizohet. Vlerësimi i jetës së dobishme, vlerës së mbetur dhe metodës së amortizimit rishikohen në fund të cdo periudhe raportuese, me efektin e ndonjë ndryshimi të llogaritur.

Jetëgjatësia e vlerësuar për periudhën aktuale dhe metodat respektive të amortizimit janë si më poshtë: Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në fund të cdo periudhe raportuese.

Kategoritë kryesore të aktiveve fikse amortizohen me metodën lineare duke përdorur jetët e dobishme të mëposhtme:

Përmirësimet e objekteve me qera	më e vogla nga kohëzgjatja e qerasë ose jeta e dobishme
Mobilje dhe instalime	5-10 vite
Pajisje informatike dhe zyre	3-5 vite
Makineri	5-8 vite

3.4 Inventari

Inventarët vlerësohen me vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme.

Kostoja përfshin të gjitha kostot e ndodhura në një situatë normale biznesi për sjelljen e inventarëve në vendodhjen dhe kushtet e tyre aktuale. Kostoja e naftës së papërpunuara është kostoja e blerjes ose kostoja e prodhimit, duke përfshirë pjesën e zhvlerësimit, firos dhe amortizimit dhe të përgjithshme bazuar në kapacitetin normal. Kostoja llogaritet në bazën e peshës mesatare.

Vlera neto e realizueshme bazohet në vlerësimin e cmimit të shitjes gjatë aktivitetit normal të biznesit duke zbritur kostot e vlerësuar për kompletimin dhe përfundimit e shitjes.

3.5 Zhvlerësimi

(i) Aktivet financiare

Një aktiv financiar është konsideruar i zhvlerësuar nëse ka evidencë objektive që tregon se një apo më shumë ngjarje kanë pasur një efekt negativ mbi flukset monetare të ardhshme të atij aktivi.

Një humbje nga rënia në vlerë e një aktivi financiar të matur me koston e amortizuar është llogaritur si ndryshim midis vlerës së tij kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme monetare të vlerësuar që janë skontuar me normën fillestare të interesit efektiv.

Një humbje nga rënia në vlerë rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që ka ndodhur pasi është njohur humbja nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

(ii) Aktivet jo-financiare

Vlera e mbetur e aktiveve jo-financiare të shoqërisë, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi ose njësieve të tij të gjenerimit të parasë tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.6 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin e një shume dhe kohëzgjatje të pasigurt.

Transoilgroup sh.a

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(shumat në mijë Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

3. POLITIKAT KONTABËL TË RËNDËSISHME (VAZHDIM)

3.7 Kostot e cmontimit

Si pasojë e natyrës së aktivitetit, Shoqëria ka impakt në mjedis. Shoqëria synon të ndjek praktikën më të mirë për mbrojtjen e mjedisit.

Bazuar në Marrëveshjen Hidrokarbure, Shoqëria duhet që në fund të koncesionit të kthejë mjedisin në gjendjen e tij mëparshme. Drejtimi ka konkluduar se Shoqëria ka detyrim për të c'montuar vetëm makineritë dhe pajisjet të vendosura pas datës së marrjes në dorëzim të zonës naftëmbajtëse dhe jo të paisjeve që kanë qenë paraprakisht të vendosura. Detyrimi për c'montim matet me vlerën aktuale të vlerësimit më të mirë të drejtimit të shpenzimeve të kërkuara për të shyer detyrimin në datën e bilancit.

Vlera aktuale e kostos së pritur për çmontimin e aktivitetit pas përdorimit të tij është përfshirë në koston e aktivitetit përkatës, nëse kriteret e njohjes për një dispozite janë plotësuar. Llogaritja e kostos së çmontimit është bazuar në modelin e fluksit të mjeteve monetare të skontuara të vlerës aktuale të shpenzimeve kapitale në normën mesatare prej 15%, për 25 vjet.

3.8 Detyrimet të ripagueshme në natyrë

Detyrimet të ripagueshme në natyrë mund kryhet në dy mënyra. Shoqëria mund të marri hua inventarë nga një palë tjetër si psh, Albpetrol ose të dorëzojë më pak naftë të papërpunuar tek Albpetrol sesa është e përcaktuar në Marrëveshjen e Hidrokarbureve. Bazuar në prodhim, ka dy lloj sasi naftë të papërpunuar të detyrueshme ndaj Albpetrolit:

- Të pagueshme në natyrë 70% të prodhimit, që pakësohet me 10% në vit, gjatë periudhës 6 mujore që pason menjëherë marrjen në dorëzim nga shoqëria të zonës naftëmbajtëse ("prodhimi i parashikuar");
- Prodhimi i mbetur do të ndahet më tej duke i kaluar në natyrë Albpetrolit një sasi (1%-6%) bazuar në rikuperimin e kostove ("sipas ndarjes së Albpetrolit") dhe faktorit R.

Detyrimet në natyrë njihen fillimisht me vlerën e drejtë. Detyrimet vlerësohen me më të voglën e vlerës së mbetur dhe vlerës së drejtë në datën e raportimit kundrejt njohjes fillestare. Për detyrimet ku Shoqëria është e detyruar t'i shlyejë në mjete monetare, në cdo datë raportimi detyrimet vlerësohen me vlerën e drejtë duke marrë parasysh ndryshimet në vlerën e drejtë të paraqitura në pasqyrën e të ardhurave. Për detyrimet që duhet të shlyhen në natyrë, humbjet regjistrohen në periudhën e mëpasshme, kurse fitimet nuk regjistrohen.

3.9 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat nga shitja e mallrave gjatë aktivitetit normal maten me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose llogarive të arkëtueshme neto nga zbritjet dhe nga taksat e lidhura me shitjet.

3.10 Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura nga interesi në llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit. Të ardhurat financiare njihen kur ato ndodhin. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë përmes fitim/ humbjes (nqs ekzistojnë) dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare

3.11 Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës, i cili njihet drejtpërdrejtë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara gjatë periudhës.

Bazuar në ligjin shqiptar si dhe në Marrëveshjen e Hidrokarbureve, shoqëria, është subjekt i tatimit mbi të ardhurat në normën 50%. Baza e tatueshme është "Fitimi nga Nafta" e cila është e përcaktuar sipas mekanizmit të faktorit R. Hidrokarburi i përfituar është pjesa e mbetur e sasisë totale të hidrokarburit të prodhuar në një periudhë të përcaktuar pasi është zbritur kostoja e hidrokarburit, e cila është pjesa e hidrokarburit të prodhuar që kontraktori ka të drejtë të përdorë për të mbuluar kostot e kapitalit dhe shpenzimeve operative, duke përfshirë 10 % taksë minerare mbi të ardhurat nga shitja. Shpenzimet e interesit, dhurimet, gjobat, shpërblimet, shpenzimet e shpërndarja nga zyra qendrore që kalojnë përtej shumës së përcaktuar nga Marrëveshja e Përbashkët të Prodhimit, dhe shpenzime të

Transoilgroup sh.a

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(shumat në mijë Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

3. POLITIKAT KONTABËL TË RËNDËSISHME (VAZHDIM)

3.11 Tatimi mbi fitimin (vazhdim)

tjera të paarsyeshme dhe të panevojshme për operacionet e hidrokarbureve janë të pa rikuperueshme. Shpenzimet e akumuluar gjatë fazës së kërkimit dhe zhvillimit janë totalisht të rikuperueshme pa qënë objekt i zhvlerësimit.

Kostot e përfundimit dhe restaurimit janë plotësisht të rikuperueshme me miratimin e vlerësimit nga AKBN, kostot e vlerësuara të përfundimit do të përfshihen në Kostot e Hidrokarbureve dhe mbulohen sipas Marrëveshjes së Hidrokarbureve dhe në kohën e dhënë në vlerësim.

4. MJETE MONETARE DHE EKVIVALENTË

Mjete monetare dhe ekuivalentë përbëhen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
<i>Arka</i>		
Mjete monetare në LEK	357	269
	357	269
<i>Banka</i>		
Llogari rrjedhëse në LEK	151	740
Llogari rrjedhëse në EUR	213	137
Llogari rrjedhëse në USD	102.436	29
	102.800	906
	103.157	1.175

5. INVENTARI

Inventari përbëhet si më poshtë:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Materiale të tjera	43.871	5.366
Hidrokarbur i papërpunuar	196.218	40.072
	240.089	45.438

6. LLOGARITË E ARKËTUESHME

Llogaritë e arkëtueshme të lidhura me hidrokarburin e papërpunuar të shitur gjatë periudhës janë Lek 160.350 mijë (31 Dhjetor 2012: Lek 172.681 mijë).

Klienti kryesor i Shoqërisë është Porto Romano Oil sh.a, e cila është një kompani e shitjes me shumicë të naftës që operon në tregun shqiptar. Llogaritë e arkëtueshme nga Porto Romano sh.a janë 125,940 mijë Lek (2012: 93.198 lekë). Porto Romano është edhe furnizuesi kryesor i tretësave dhe duke marrë parasysh raportet klient/furnitor, Shoqëria e ka vlerësuar këtë shumë si plotësisht të rikuperueshme dhe nuk ka krijuar provision për borxhe të këqija.

7. PARAPAGIME DHE SHPENZIME TË SHTYRA

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra përbëhen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Garancitë për qeratë	726	1.812
Shpenzimet e parapaguara ndaj furnitorëve	206.635	282
	207.361	2.094

Parapagimet në vitin 2013 kanë të bëjnë me parapagimin e 2 milion USD sipas kontratës me Simmons Edeco Limited për shpimin e puseve të reja që kanë filluar në Dhjetor 2013 dhe do të vazhdojnë përgjatë vitit 2014.

Transoilgroup sh.a

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(shumat në mijë Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

8. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE

Aktivët afatgjata materiale më 31 Dhjetor 2013 dhe 2012 përbëhen si më poshtë:

	Hidrokarburet	Mobilje dhe instalime	Pajisje informatike dhe zyre	Makineri	Ndërtime në proces	Të tjera	Totali
Kosto							
Më 1 Janar 2012	-	-	-	-	-	-	-
Shtesa	307.045	1.309	2.694	29.735	51.644	3.830	396.257
Më 31 Dhjetor 2012	307.045	1.309	2.694	29.735	51.644	3.830	396.257
Shtesa	280.526	1.000	4.804	4.200	30.754	4.924	326.208
Më 31 Dhjetor 2013	587.571	2.309	7.498	33.935	82.398	8.754	722.465
Amortizimi i akumuluar							
Më 1 Janar 2012	-	-	-	-	-	-	-
Shpenzimi i periudhës	129	126	321	2.202	-	77	2.855
Më 31 Dhjetor 2012	129	126	321	2.202	-	77	2.855
Shpenzimi i periudhës	16.954	311	1.132	6.199	-	181	24.777
Më 31 Dhjetor 2013	17.083	437	1.453	8.401	-	258	27.632
Vlera kontabël neto më 31 Dhjetor 2012	306.916	1.183	2.373	27.533	51.644	3.753	393.402
Vlera kontabël neto më 31 Dhjetor 2013	570.488	1.872	6.045	25.534	82.398	8.496	694.833

Transoilgroup sh.a

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(shumat në mijë Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

9. DETYRIMET AFATAGJATA

Detyrimet afatgjata më 31 Dhjetor 2013 dhe 2012 janë të përbëra si më poshtë:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Detyrimet afatagjata ndaj Porto Romano	900.207	-
Detyrimet afatagjata ndaj Albpetrol	42.058	42.058
Provizion për cmontim	1.287	907
	943.552	42.965

Pasi Shoqëria mori në kontroll zonën naftëmbajtëse, disa sasi të inventarit të hidrokarbureve të papërpunuara, të cilat i përkisnin Albpetrol u lanë në magazinë. Kjo sasi do të rikthehet pasi Marrëveshja e Përbashkët e Prodhimit të mbarojë.

Detyrimet afatgjata ne lidhje me Porto Romano-n kanë të bëjnë me holluesin e blerë i cili përdoret në procesin e nxjerrjes së naftës. Shoqëria ka nënshkruar një marrëveshje likuidimi me Porto Romano sh.a, në 3 Dhjetor 2013, ku 1/3 e pagesës do të kryhet brenda 12 muaj, dhe 2/3 do të kryhet pas 12 muaj nga data marrjes së faturës nga Shoqëria. Pjesa afatgjatë lidhet me 2/3 të shumës, dhe pjesa afatshkurtër e paraqitur në shënimin shpjegues 10 lidhet me 1/3 të shumës kundrejt Porto Romano sh.a.

Provizioni i cmontimit lidhet me obligimin e shoqërisë për zhvendosjen e aktiveve të veta dhe kthimin e mjedisit në gjendjen e mëparshme sipas Marrëveshjes së Përbashkët të Prodhimit.

Lëvizjet në provizionet e cmontimit janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Më Janar 2013	907	-
Shpenzimi i periudhës	380	907
Më Dhjetor 2013	1.287	907

10. LLOGARITË E PAGUESHME

Llogaritë e pagueshme janë detyrime pa interes ndaj furnitorëve vendas dhe të huaj dhe janë të vendosura zakonisht në një periudhë që varion nga 30 deri në 180 ditë.

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Ndaj Porto Romano-detyrim afatshkurër (holluesi)	450.103	457.162
Ndaj furnitorëve të tjerë	211.047	281.831
Të përllogaritura për furnitorët	336	3.108
	661.486	742.101

Transoilgroup sh.a

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(shumat në mijë Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

11. LLOGARI TË PAGUESHME TË TJERA

Llogaritë e pagueshme të tjera më 31 Dhjetor 2013 dhe 2012 janë të përbëra si më poshtë:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Ndaj Albpetrol	27.678	123.155
Ndaj punonjësve	4.226	11.275
Sigurime shoqërore	2.053	2.034
Tatimi mbi pagat	1.325	1.667
Të tjera të pagueshme	4.715	709
	39.997	138.840

Llogaritë e pagueshme ndaj Albpetrol paraqesin provizionin që Shoqëria ka njohur për sasinë e hidrokarbureve të papërpunuara të cilën Shoqëria ia ka derguar Albpetrol në përputhje me Marrëveshjen e Përbashkët të Prodhimit më 31 Dhjetor 2013. Kjo sasi është një përlllogaritje dhe mund të ndryshojë derisa një shumë e tillë të auditohet nga AKBN ose Albpetrol, megjithatë drejtimi nuk pret ndonjë ndryshim të rëndësishëm.

12. KAPITALI AKSIONER

Kapitali aksioner fillestar i kontribuar nga aksionerët e shoqërisë me efekt në vitin 2012 ishte Lek 10.000 mijë.

	2013			2012		
	<i>Numri i aksioneve</i>	<i>% Pronësisë</i>	<i>Vlera nominale në ALL' 000</i>	<i>Numri i aksioneve</i>	<i>% Pronësisë</i>	<i>Vlera nominale në ALL'000</i>
Transoilgroup AG - Zvicër	100'000	100%	10'000	100'000	100%	10'000
	100'000	100%	10'000	100'000	100%	10'000

13. HUAMARRJET

Qeraja financiare

Më 29 Qershor 2012 Shoqëria nënshkroi një marrëveshje qeraje financiare tre vjecare për gjashtë makineri për një total të qerasë financiare Euro 58.450. Kjo marrëveshje ka një përqindje vjetore interesi prej Euribor 12M + 1.54%.

Makineritë me qera sipas kësaj marrëveshje janë vendosur si siguri për detyrimet e kësaj qeraje financiare.

Maturimet e detyrimeve afatgjata janë paraqitur si më poshtë:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Brenda një viti	2.159	2.172
Pas një viti por jo më shumë se pesë vjet	1.510	3.692
Më shumë se pesë vjet	-	-
	3.669	5.864

Transoilgroup sh.a

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(shumat në mije Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

14. TË ARDHURAT

Të ardhurat për fundin e vitit 31 Dhjetor 2013 dhe 2012 përfshijnë shitjet e hidrokarbureve të papërpunuara në tregun vendas. Klientët e vetëm të Shoqërisë janë Porto Romano sh.a dhe Kesi Sh.p.k, të cilët përbëjnë përkatësisht 66% dhe 34% të shitjeve totale.

15. SHPENZIMET PËR MATERIALE

Shpenzimet për materiale për fundin e vitit 31 Dhjetor 2013 dhe 2012 përbëhen si më poshtë

	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2013	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2012
Kostot e lëndës tretëse – puse	(504.536)	(266.445)
Kostot e lëndës tretëse- ne shtrese	(387.096)	(257.276)
Taksa dhe detyrime	(88.673)	(44.258)
Energji elektrike	(31.187)	(26.846)
Materiale te tjera	(18.059)	(20.043)
Hidrokarbure të papërpunuara	72.168	(129.065)
	(959.849)	(764.538)

Fusha e Visokës ka një viskozitet të lartë të naftës, e cila ka tendencë të çojë në lëvizshmëri të ulët të naftës dhe e bën të vështirë nxjerrjen e saj. Injektimi i tretësit (holluesit) ka qenë metoda kryesore e përdorur për të përmirësuar lëvizshmërinë e naftës. Tretësi i injektuar në shtresë është përdorur për të rritur lëvizshmërinë e naftës dhe për të sjellë naftën në afërsi të puseve, ku një tjetër sasi tretësi është injektuar në tubin e pusit për të lehtësuar nxjerrjen në sipërfaqe të pusit, dhe më pas në objektet e magazinimit.

Kostot e naftës së papërpunuar, më 31 Dhjetor 2012 është e lidhur me njohjen e detyrimit kundrejt Albpetrol për Prodhimin Para-Ekzistues ("PPE") dhe Pjesën e Prodhimit për Albpetrol ("PPA") në përputhje me Marrëveshjen e Përbashkët të Prodhimit.

Detyrimi i njohur matet në Brent dhe në kosto të naftës që është prodhuar, e cila është më e ulët se Brent. Diferenca e detyrimit i matur në Brent kundrejt shpenzimit të njohur duke përdorur koston e prodhimit të naftës, njihet nën zërin e shpenzimeve të tjera operative të paraqitura në shënimin shpjegues 18.

Njohja e detyrimit për Albpetrol në vitin 2012 është një qasje konservatore e ndjekur nga Shoqëria duke shpenzuar të gjithë detyrimin në vitin 2012. Gjatë vitit 2013 Shoqëria ka transferuar naftë të Albpetrol duke ulur detyrimin e tij ndaj Albpetrolit dhe gjithashtu reduktimin e shpenzimeve për naftë bruto, të cilat ishin regjistruar më parë në vitin 2012. Sic shpjegohet në shënimin shpjegues 18, detyrimet per PPE jane paguar ne nafte bruto ne 2013.

16. SHPENZIME PERSONELI

Shpenzimet e personelit për fundin e vitit 31 Dhjetor 2013 dhe 2012 përbëhen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2013	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2012
Kostot e personelit të prodhimit	(99.966)	(93.746)
Kostot e personelit të administratës	(66.486)	(47.426)
	(166.452)	(141.172)

Transoilgroup sh.a

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(shumat në mijë Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

17. SHPENZIMET E PËRGJITHSHME DHE ADMINISTRATIVE

Shpenzime të tjera për fundin e vitit 31 Dhjetor 2013 dhe 2012 përbëhet si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2013	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2012
Tarifa konsulence	(45.037)	(14.234)
Përmirësime në puse dhe në dekantim	(44.607)	(1.891)
Shpenzime indirekte menaxhimi	(36.761)	(36.938)
Shërbime ruajtje	(17.835)	(12.662)
Shpenzime qeraje operative dhe financiare	(15.423)	(15.590)
Udhëtime dhe dieta	(13.529)	(6.140)
Riparimi dhe mirëmbajtje	(13.313)	(5.420)
Shpenzime telekomunikacioni	(4.157)	(2.548)
Shpenzime uji, gas dhe energji	(3.344)	(6.333)
Shpenzime primi sigurie	(533)	(444)
Shpenzime testimi	(172)	(2.021)
Shpenzime të tjera administrative	(12.954)	(14.441)
	(207.665)	(118.662)

18. TË ARDHURA/SHPENZIME TË TJERA, NETO

	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2012	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2011
Transaksione me palët e lidhura	-	(192.657)
Kostot e cmontimit	(379)	(907)
Taksa lokale	(3.316)	(37)
Të ardhura/(shpenzime) kundrejt detyrimit me Albpetrol, matur në Brent	30.707	(36.897)
	27.012	(230.499)

Transaksionet me palët e lidhura në vitin 2012 përbëhen nga shpenzimet e operatorit të mëparshëm IEC Visoka të cilat janë marrë përsipër dhe janë paguar nga Transoilgroup AG gjatë marrjes së marrëveshjes së naftës. Këto shpenzime janë transferuar si një detyrim nga Transoilgroup AG drejt Shoqërisë.

Në vitin 2012 Shoqëria ka përllogaritur të tërë detyrimin për PEP ndaj Albpetrol 3,022.05 metrik ton (MT) të matur në Brent në shumën 123.155 mijë lekë (shënimi 11), dhe e ka njohur atë në pasqyrën e të ardhurave. Detyrimi mund të paguhet ose me para në dorë bazuar në çmimet aktuale Brent ose në naftë.

Shoqëria ka pakësuar detyrimin për Albpetrol gjatë vitit 2013 nëpërmjet lëvrimit të 2,504.45 MT naftë e cila njihet me kosto, dhe rrjedhimisht detyrimi i Albpetrol që përfaqëson tejkalimin e Brent nga kostoja është përmbysur dhe është njohur në të ardhurat e vitit.

19. TË ARDHURA FINANCIARE

Humbjet nga kurset e këmbimit, neto për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013 dhe 2012 përbëhen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2013	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2012
Të ardhurat financiare	30	36
Fitimet nga ndryshimi i kursit të këmbimit	28.536	648
	28.566	684

Transoilgroup sh.a

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(shumat në mijë Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

20. SHPENZIMET FINANCIARE

Të ardhurat nga interesi, neto për fundin e vitit 31 Dhjetor 2013 dhe 2012 përbëhen :

	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2013	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2012
Shpenzimet e interesit	(584)	(380)
Humbjet nga ndryshimi i kursit të këmbimit	(1.260)	(5.731)
	(1.844)	(6.111)

Shpenzimet e interesit rezultojnë nga marrja me qera operative të makinave nga Landeslease Sh.a.

21. TATIM FITIMI

Norma ligjore e tatimit të shoqërisë mbi hidrokarburet është 50% për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013 (2012: 50%) (ju lutem shikoni shënimin 3.11)

Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013 Shoqëria ka një humbje nga tatimi prej Lek 2.397.757 mijë, e cila mund të mbartet në një kohë të pacaktuar dhe të zbritet kundrejt fitimeve të ardhshme, kur dhe nëse është e mundur. Shoqëria ka vendosur opsionin të mos rregjistrojë ndonjë aktiv apo detyrim mbi tatimin e shtyrë në pasqyrat e saj financiare.

Balancat tatimore janë njohur si pozicione jashtë bilancit derisa ato të realizohen.

	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2013	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2012
Fitim/(humbje) i periudhës para tatimit	(848.086)	(759.625)
Plus: Shpenzimet e pazbritshme	20.733	199.183
Plus: Shpenzimet PEP+ASP	(102.876)	123.139
Shpenzime për zgjerim kapitali	(326.207)	(396.256)
Fitim/(humbje) e tatueshme për vitin	(1.256.437)	(833.599)
Humbjet e taksueshme të mbartura	(1.141.320)	(307.761)
Fitim/(humbje) e tatueshme në fund të vitit	(2.397.757)	(1.141.320)

Shpenzimet e pazbritshme janë përgjithësisht shpenzime pa dokumenta mbështetës të duhura për qëllime tatimore.

Në vitin 2012 Shoqëria ka njohur detyrime ndaj Albpetrol për PPE dhe PPA në Brent për shumën 123.139 mijë lekë, e cila është shpenzuar gjatë vitit dhe shtohet përsëri pasi sipas Marrëveshjes së Ndarjes së Hidrokarbureve është shpenzim jo i zbritshëm. Gjatë vitit 2013 Shoqëria ka reduktuar detyrimin e saj duke transferuar sipas PPE dhe PPA pjesën e naftës të Albpetrol dhe duke qënë që këto kosto janë jo të zbritshme, janë shtuar përsëri për qëllime tatimore.

Humbjet tatimore të mbartura përfaqësojnë kosto hidrokarburi të parikuperuar të kryera gjatë viteve të mëparshme.

Kthimet tatimore janë të paraqitura çdo vit, por fitimet ose humbjet e deklaruara për qëllime tatimore mbeten të provizionuara derisa autoritetet (Albpetrol dhe AKBN) të shqyrtojnë kthimet dhe rregjistrimet e taksapaguesve dhe të lëshojnë një vlerësim final. Nafta e përfituar dhe kostot e parikuperuara janë subject i Ligjit të Hidrokarbureve dhe Marrëveshjes së Perbashkët të Hidrokarbureve (Referojuni shënimin 3.11).

Transoilgroup sh.a

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(shumat në mijë Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

22. PALËT E LIDHURA

Shoqëria kontrollohet nga Shoqëria mëmë Transoilgroup A.G, Zvicër e cila ka mundësuar fondet e nevojshme për vazhdimësinë e operacioneve të hidrokarbureve.

Tabela e mëposhtme paraqet sasinë totale të transaksioneve që janë kryer me palët e lidhura për vitin përkatës financiar.

A) Blerje mallrash dhe shërbimesh

	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2013	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2012
Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative të paguara nga Shoqëria mëmë në emër të Transoilgroup SHA	343.004	15.874
Kosto të shpërndara	37.460	39.988
	380.464	55.862

B) Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Shoqëria ka llogari të pagueshme ndaj përfaqësuesit ligjor të shoqërisë Z. Shefqet Dizdari, i cila ka bërë një parapagesë në emër të shoqërisë.

Transoilgroup sh.a.mori në kontroll zonën naftëmbajtëse nga operatori i mëparshëm I.E.C Visoka Sh.p.k, ku të drejtat dhe detyrimet i janë transferuar asaj.

Në datën e raportimit, llogaritë e pagueshme të mëposhtme ju detyrohen palëve të lidhura:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Financime nga Shoqëria mëmë	689.689	150.157
Shuma të paguara në emër të Transoilgroup SHA	402.013	59.013
Kosto të shpërndara	75.940	39.986
Detyrimet e akumuluar nga operatori i mëparshëm	191.661	187.750
Ndaj Transoilgroup AG	1.359.303	436.906
Ndaj administratorit	3.550	3.550
	1.362.853	440.456

Vlera e kompensimeve për drejtimin është 9,472 mijë Lekë (2012: 9,520 mijë Lekë). Asnjë kompensim tjetër nuk është bërë ndaj grupeve të drejtimit nga Shoqëria.

Natyra e marrëdhënies me palët e lidhura

Shoqëria ka hyrë në këto transaksione me palët e lidhura të mësipërme me kushte reciproke për të cilat është rënë dakort.

Termet dhe kushtet e transaksioneve me palët e lidhura

Shitjet dhe blerjet nga palët e lidhura janë kryer sipas cmimit normal të tregut. Balancat e mbetura ende në fund të periudhës janë të pasiguruara, pa pagesë interesi dhe shlyerja ndodh në mjete monetare. Nuk ka asnjë garanci të dhënë ose të marrë ndaj llogarive të pagueshme ose të arkëtueshme me palët e lidhura. Më 31 Dhjetor 2013, Shoqëria nuk ka bërë ndonjë fshirje për borxhe të dyshimta me palët e lidhura (2012: zero). Ky vlerësim ndërmerret cdo vit duke ekzaminuar pozicionin financiar të palëve të lidhura dhe tregun në të cilën palët e lidhura operojnë.

Transoilgroup sh.a

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(shumat në mije Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

23. ANGAZHIMET DHE PASIGURITË

Angazhimet

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Brenda një viti		
Angazhime qeraje	3.142	10.900
Angazhime zgjerim kapitali	63.414	63.414
	66.556	74.314
Pas 1 por jo më shumë se 5 vjet		
Angazhime qeraje	6.388	21.200
Angazhime zgjerim kapitali	317.070	317.070
	323.458	338.270
Më shumë se 5 vjet		
Angazhime qeraje	5.048	5.048
Angazhime zgjerim kapitali	1.204.866	1.204.866
	1.209.914	1.209.914
	1.599.928	1.622.498

Angazhimet lidhen me qeratë operative për hapësirat e zyrave dhe qirasë financiare për tokën. Sipas Marrëveshjes të Koncesionit, Shoqëria është e detyruar të shpenzojë të paktën 600,000 USD dhe të zgjerojë Planin e Vlerësimit duke përfshirë aktivitete shtesë dhe të punojë mbi puse shtesë brenda Zonës së Projektit.

Cështjet ligjore

Më 31 Dhjetor 2013 Shoqëria nuk është subjekt i ndonjë cështjeje ligjore dhe ankimeve të lindura gjatë rrjedhës së zakonshme të biznesit.

Transoilgroup sh.a

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(shumat në mije Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

24. NGJARJET PAS DATËS SË BILANCIT

Ndyshime në pronësi

Aksionerët e shoqërisë mëmë Transoilgroup AG në 17 qershor 2014, kanë nënshkruar një Marrëveshje të Blerjes së Aksioneve për blerjen e një pakice aksionesh të aksionerëve të shoqërisë nga Z. Behar Cukaj, pala kontrolluese përfundimtare e Porto Romanos.

Porto Romano është furnizuesi kryesor i tretësve të Shoqërisë dhe klienti kryesor i naftës bruto të Shoqërisë; rrjedhimisht, në datën e marrëveshjes Porto Romano bëhet palë e lidhur e Shoqërisë.

Pas transferimit të aksioneve, aksionerët e Transoilgroup AG kanë transferuar drejt Transoilgroup sh.a. të ardhurat nga shitja në formën e një kredie pa interes dhe pa maturitet të përcaktuar, në shumën 6 milionë USD.

Investime të rëndësishme kapitale

Shoqëria dhe Porto Romano më 26 korrik 2014 kanë nënshkruar një Marrëveshje shpuese Turnkey siç shpjegohet në detaje në Shënimin 2.5. Duke u mbështetur në këtë marrëveshjes, Porto Romano ka përgatitur fushën për të shpuar tre puse dhe është në procesin e sjelljes së sondës në vendndodhje. Deri në fund të nëntorit 2014 tre puse horizontale duhet të jenë shpuar dhe të gatshëm për nxjerrjen e naftës.

Nënshkrimi i borxhit

Më 31 korrik 2014 Porto Romano ka nënshkruar një marrëveshje me Transoilgroup sh.a ku Porto Romano nënshkruan të gjitha kërkesat e saj aktuale për tretës në shumën Lek 1.491.071.706 ose USD 14.477.829 deri më 30 qershor 2014 (Lek 900.207.000 ose USD 8.837.688 më 31 dhjetor 2013) dhe kërkesa të ardhshme për furnizime me tretës, kundrejt të gjitha borxhet e tjera të pranishme ose të ardhshme të pasigurta të Transoilgroup sh.a kundër të gjithë kreditorëve të tjerë.

Nuk ka ngjarje të tjera të rëndësishme pas datës së raportimit që kërkojnë rregullime ose shpalosje në këto pasqyra financiare.